



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2698/7 prot.

Datë 13.11.2025

V E N D I M
Nr.1665/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Ouen” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62685-09-25-2025, me objekt: “Ndërtim Blloku Paskuqan 2”, me fond limit 107,003,399.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 13.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Ouen” SHPK me NIPT K17529215O dhe adresë: Lagjia Shemri, Rruga Nacionale Shemri-Kukes Km2, Kukës.

Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK me NIPT J91915001P dhe adresë, Lagjia Zall - Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamez, 1054.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz.

Adresa: Bulevardi "Nënë Tereza" nr.492 Kamëz Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*". Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.09.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62685-09-25-2025, me objekt: “Ndërtim Blloku Paskuqan 2”, me fond limit 107,003,399.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 13.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 01.10.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Ouen” SHPK, me nr. 2698/2025 prot., datë 01.10.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5872, datë 01.10.2025 dhe ankesa nr. 2698/1/2025 prot., datë 01.10.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5873, datë 01.10.2025 duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.2.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndrushuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.2.2. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.8633/1 prot., datë 08.10.2025, me objekt “Shkresë përcjellëse”, protokolluar me tonën me nr.2698/2 prot., datë 13.10.2025, ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) nr.8633 prot., datë 08.10.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Ouen” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, Referuar këtij vendimi rezulton, se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës si më poshtë:

[...]

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik, ku ndër të tjera **operatori ekonomik ankimues pretendon**: “...Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon:*

- *Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST;*
 - *Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës 2.3.2 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST.*
 - *Stafi inxhinierik (drejtues teknik) kërkuar sipas pikës 2.3.3 dhe stafin e specializuar e licensimet sipas pikes 2.3.4(b,c) të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST.*
 - *Certifikatat ISO kerkuar sipas pikës 2.3.9, të Kapacitetit teknik te KVK, të shtojcës 7, të DST*
- Në lidhje me parashikimet e kësaj pike vlerësojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me parashikimet ligjore të përcaktuara nga neni 84 i ligjit nr.162/2020 “për prokurimin publik” të ndryshuar...”*

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pasi analizoi përmbajtjen e dokumenteve të tenderit, natyrën e objektit të kontratës dhe kërkesat e vendosura në DST, vlerësoi të arsyeshëm dhe në përputhje me ligjin ndryshimin e pikës 2.16 "Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera".

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po X Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon:

- **Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST;**
- **Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës 2.3.2 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST.**
- **Certifikatat ISO kërkuar sipas pikës 2.3.9, të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST**

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi përvoja për të zbatuar kontratën, licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, stafi inxhinierik (drejtuesit teknik), Stafi teknik si dhe Certifikata ISO vlerësohen kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar Modifikimi i propozuar është ligjërish i mbështetur, teknikisht i justifikuar dhe në interes të zbatimit efektiv të kontratës publike.

Për sa më sipër, qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht.

Operatori ekonomik ankimues pretendon: "...Në këtë kontekst e mbështetur në dispozitat e cituara më sipër gjykojmë se një pjese dërmuese e stafit mbështetës nuk është aspak proporcionale me objektin e kontratës, çka përbën në vetvete diskriminim dhe uljen dhe minimizimin e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë të vegjël e të mesëm....

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", KSHA vlerëson që DST duhet të modifikohet si më poshtë:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në liçensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshader

1 (një) Inxhinier Gjeolog

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara

publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V.

Modifikimi i DST është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST.

Për sa më sipër, qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht.

Operatori ekonomik ankimues pretendon: "...Në pikën 2.3.5. të Kapacitetit teknik të DT-ve, AK ka përcaktuar kriterin si më poshtë: **2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 67 (gjashtëdhjetë e shtatë)** punonjës për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Pika 2.3.5 e DST së procedurës së prokurimit të modifikohet, ku operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave ku përfshihen edhe stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Qëllimi i modifikimit së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 60 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 188 dite pune, nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre". Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur m kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht.

Operatori ekonomik ankimues pretendon: "...Në pikën 2.3.8. të Kapacitetit teknik të DT-ve, AK ka përcaktuar kriterin si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit):

Pika 42 e tabelës së makinerive...

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Pika 42 e tabelës së mjeteve të modifikohet si më poshtë:

42. Impiant (fabrikë) prodhim asfalti me QKL III.1.B. Në rastin kur Operatorët paraqesin kontratë furnizimi, ky kriter do të konsiderohet i plotësuar me paraqitjen e kontratës dhe nuk është e domosdoshme paraqitja me QKL III.1.B.

Për sa më sipër, qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron.

Operatori ekonomik ankimues pretendon: "...Në pikën 2.3.12. të Kapacitetit teknik të DT-ve, AK ka përcaktuar kriterin si më poshtë:

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN ISO SSH EN ISO 12350-2:2019, SSH EN ISO 12504-2:2021, SSH EN ISO 6982 - 1:2019, SSH EN 1 ISO 2390-8:2019....

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron. KSHA vlerëson se ky kriter duhet të hiqet nga kriteret e DST së procedurës së prokurimit.

II.2.3. Me shkresën nr.2698/3 prot., datë 15.10.2025, me objekt "Kërkesë për paraqitje dokumentacioni", Komisioni iu drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacionin si më poshtë: [...]Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion lidhur me përllogaritjen e fondit limit (të preventivit me çmime), përllogaritjen analitike për fuqinë punëtore dhe përllogaritjen analitike për mjetet e kërkuara, mbi bazën e preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve, të njehsuara me origjinalin dhe të numerizuara nga ana e autoritetit tuaj kontraktor.

II.2.4. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr.9077/2 prot., datë 28.10.2025, me objekt "Shkresë përcjellëse", protokolluar me tonën me nr.2698/4 prot., datë 30.10.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin e kërkuar.

II.3.Në datën 02.10.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik "Almo Konstruksion" SHPK, me nr. 2716/2025 prot., datë 02.10.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5880, datë 02.10.2025, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.3.2. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.8634/1 prot., datë 08.10.2025, me objekt "Shkresë përcjellëse", protokolluar me tonën me nr.2716/1 prot., datë 13.10.2025, ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, Vendimin e Komisionit të

Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) nr.8634 prot., datë 08.10.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Almo Konstruktion” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, Referuar këtij vendimi rezulton, se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës si më poshtë:

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik, ku ndër të tjera **operatori ekonomik ankimues pretendon**: “...Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon:*

- *Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST;*
 - *Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës 2.3.2 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST.*
 - *Stafi inxhinierik (drejtues teknik) kërkuar sipas pikës 2.3.3 dhe stafin e specializuar e licensimet sipas pikes 2.3.4(b,c) të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST.*
 - *Certifikatat ISO kerkuar sipas pikës 2.3.9, të Kapacitetit teknik te KVK, të shtojcës 7, të DST*
- Në lidhje me parashikimet e kësaj pike vlerësojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me parashikimet ligjore të përcaktuara nga neni 84 i ligjit nr.162/2020 “për prokurimin publik” të ndryshuar...”*

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pasi analizoi përmbajtjen e dokumenteve të tenderit, natyrën e objektit të kontratës dhe kërkesat e vendosura në DST, vlerësoi të arsyeshëm dhe në përputhje me ligjin ndryshimin e pikës 2.16 "Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera".

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po X Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon:

- *Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST;*
- *Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës 2.3.2 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST.*
- *Certifikatat ISO kerkuar sipas pikës 2.3.9, të Kapacitetit teknik te KVK, të shtojcës 7, të DST*

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi përvoja për të zbatuar kontratën, licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, stafi inxhinierik (drejtuesit teknik), Stafi teknik si dhe Certifikata ISO vlerësohen kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar Modifikimi i propozuar është ligjërish i mbështetur, teknikisht i justifikuar dhe në interes të zbatimit efektiv të kontratës publike.

Për sa më sipër, qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht.

Operatori ekonomik ankimes pretendon: "...Në këtë kontekst e mbështetur në dispozitat e cituara më sipër gjykojmë se një pjesë dërmuese e stafit mbështetës nuk është aspak proporcionale me objektin e kontratës, çka përbën në vetvete diskriminim dhe uljen dhe minimizimin e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë të vegjël e të mesëm....

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", KSHA vlerëson që DST duhet të modifikohet si më poshtë:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në liçensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshader

1 (një) Inxhinier Gjeolog

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V.

Modifikimi i DST është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST.

Për sa më sipër, qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht.

Operatori ekonomik ankimes pretendon: "...Në pikën 2.3.8. të Kapacitetit teknik të DT-ve, AK ka përcaktuar kriterin si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit):

Pika 42 e tabelës së makinerive...

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Pika 42 e tabelës së mjeteve të modifikohet si më poshtë:

42. Impiant (fabrikë) prodhim asfalti me QKL III.1.B. Në rastin kur Operatorët paraqesin kontratë furnizimi, ky kriter do të konsiderohet i plotësuar me paraqitjen e kontratës dhe nuk është e domosdoshme paraqitja me QKL III.1.B.

Për sa më sipër, qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron.

Operatori ekonomik ankimues pretendon: "...Në pikën 2.3.12. të Kapacitetit teknik të DT-ve, AK ka përcaktuar kriterin si më poshtë:

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN ISO SSH EN ISO 12350-2:2019, SSH EN ISO 12504-2:2021, SSH EN ISO 6982 - 1:2019, SSH EN 1 ISO 2390-8:2019....

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron. KSHA vlerëson se ky kriter duhet të hiqet nga kriteret e DST së procedurës së prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Ouen” SHPK dhe operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.8633/1 prot., datë 08.10.2025, me objekt “Shkresë përcjellëse”, protokolluar me tonën me nr.2698/2 prot., datë 13.10.2025, ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) nr.8633 prot., datë 08.10.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Ouen” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar këtij vendimi rezulton, se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

III.1.2. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.8634/1 prot., datë 08.10.2025, me objekt “Shkresë përcjellëse”, protokolluar me tonën me nr.2716/1 prot., datë 13.10.2025, ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) nr.8634 prot., datë 08.10.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Almo Konstruksion” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, Referuar këtij vendimi rezulton, se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimi i Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) nr.8633 prot., datë 08.10.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Ouen” SHPK dhe Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) nr.8634 prot., datë 08.10.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Almo Konstruksion” SHPK për procedurën e prokurimit objekt ankimi konstaton se, të dy vendimet

e sipërcituara të KSHA, të cilët kanë vendosur pranimin pjesërisht të ankesave të operatorëve ekonomikë ankimes, kanë përmbajtje të njëjtë, e cila rezulton të jetë si më poshtë:

[...]

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik, ku ndër të tjera **operatori ekonomik ankimes pretendon**: “...Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon:

- **Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST;**
 - **Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës 2.3.2 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST.**
 - **Stafi inxhinierik (drejtues teknik) kërkuar sipas pikës 2.3.3 dhe stafin e specializuar e licensimet sipas pikes 2.3.4(b,c) të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST.**
 - **Certifikatat ISO kërkuar sipas pikës 2.3.9, të Kapacitetit teknik te KVK, të shtojcës 7, të DST**
- Në lidhje me parashikimet e kësaj pike vlerësojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me parashikimet ligjore të përcaktuara nga neni 84 i ligjit nr.162/2020 “për prokurimin publik” të ndryshuar...”

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pasi analizoi përmbajtjen e dokumenteve të tenderit, natyrën e objektit të kontratës dhe kërkesat e vendosura në DST, vlerësoi të arsyeshëm dhe në përputhje me ligjin ndryshimin e pikës 2.16 "Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera".

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po X Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon:

- **Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST;**
- **Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës 2.3.2 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST.**
- **Certifikatat ISO kërkuar sipas pikës 2.3.9, të Kapacitetit teknik te KVK, të shtojcës 7, të DST**

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi përvoja për të zbatuar kontratën, licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, stafi inxhinierik (drejtuesit teknik), Stafi teknik si dhe Certifikata ISO vlerësohen kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar Modifikimi i propozuar është ligjërish i mbështetur, teknikisht i justifikuar dhe në interes të zbatimit efektiv të kontratës publike.

Për sa më sipër, qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht.

Operatori ekonomik ankimues pretendon: "...Në këtë kontekst e mbështetur në dispozitat e cituara më sipër gjykojmë se një pjese dërmuese e stafit mbështetës nuk është aspak proporcionale me objektin e kontratës, çka përbën në vetvete diskriminim dhe uljen dhe minimizimin e konkurrencës mes operatorëve ekonomikë të vegjël e të mesëm....

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", KSHA vlerëson që DST duhet të modifikohet si më poshtë:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) InxhinierGjeodet/Topograf/Markshader

1 (nje) Inxhinier Gjeolog

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V.

Modifikimi i DST është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST.

Për sa më sipër, qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht.

Operatori ekonomik ankimues pretendon: "...Në pikën 2.3.5. të Kapacitetit teknik të DT-ve, AK ka përcaktuar kriterin si më poshtë: **2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 67 (gjashtëdhjetë e shtatë)** punonjës për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Pika 2.3.5 e DST së procedurës së prokurimit të modifikohet, ku operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave ku përfshihen edhe stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Qëllimi i modifikimit të këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Nga ana teknike

argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 60 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 188 dite pune, nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre". Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur m kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht.

Operatori ekonomik ankimues pretendon: "...Në pikën 2.3.8. të Kapacitetit teknik të DT-ve, AK ka përcaktuar kriterin si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit):

Pika 42 e tabelës së makinerive...

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Pika 42 e tabelës së mjeteve të modifikohet si më poshtë:

42. Impiant (fabrikë) prodhim asfalti me QKL III.1.B. Në rastin kur Operatorët paraqesin kontratë furnizimi, ky kriter do të konsiderohet i plotësuar me paraqitjen e kontratës dhe nuk është e domosdoshme paraqitja me QKL III.1.B.

Për sa më sipër, qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron.

Operatori ekonomik ankimues pretendon: "...Në pikën 2.3.12. të Kapacitetit teknik të DT-ve, AK ka përcaktuar kriterin si më poshtë:

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN ISO SSH EN ISO 12350-2:2019, SSH EN ISO 12504-2:2021, SSH EN ISO 6982 - 1:2019, SSH EN 1 ISO 2390-8:2019....

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, vlerëson si më poshtë:

Qëndrimi i operatorit ekonomik qëndron. KSHA vlerëson se ky kriter duhet të hiqet nga kriteret e DST së procedurës së prokurimit.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit

115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën në përputhje me këto pretendime të pranuar. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të marrë masa për publikimin në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, të shtojcës për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me pretendimet e pranuar nga KSHA në vendimin nr.8633 prot., datë 08.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2698/2 prot., datë 13.10.2025, dhe vendimit të KSHA nr.8634 prot., datë 08.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2716/2 prot., datë 13.10.2025,

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, vendosi të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave për procedurën e prokurimit të sipërcituar, si dhe të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesave.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Ouen” SHPK dhe operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për pikën 2.16. “Mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera” të dokumenteve të tenderit, për të cilën kërkojnë: operatori ekonomik “Ouen” SHPK të lejohet mbështetja në kapacitetet teknike të subjekteve të tjerë lidhur me licencat profesionale sipas niveleve për cdo kategori punimesh kërkuar sipas pikës 2.3.2 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST, ndërsa operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK të lejohet mbështetja në kapacitetet teknike të subjekteve të tjera dhe të mos ketë kufizim në kapacitetet që duhet të mbështetesh, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në pikën 2.16 të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Ofertuesve nuk u lejohe të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon:

- **Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST;**
- **Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës 2.3.2 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST.**
- **Stafi inxhinierik (drejtues teknik) kërkuar sipas pikës 2.3.3 dhe stafin e specializuar e licensimet sipas pikes 2.3.4(b,c) të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST.**
- **Certifikatat ISO kërkuar sipas pikës 2.3.9, të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DST**

Ofertuesve nuk u lejohe të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi përvoja për të zbatuar kontratën, licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, stafi inxhinierik (drejtuesit teknik), Stafi teknik si dhe Certifikata ISO vlerësohen kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar bindjen te AK se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standardeve të kërkuara.

III.2..2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.2.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.2.5. Në nenin 84 pika 1,3 dhe 6 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.”

III.2.6. Në nenin 39 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të

jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

III.2.7. Në nenin 90 pika 1 dhe 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se: *“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.*

6.Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.”

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlereson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.2.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Almo Konstruksion” SHPK, i cili kërkon që të hiqet kufizimi i vënë nga autoriteti kontraktor që nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për të provuar përvojën e mëparshme të ngjashme, përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve objekt i kontratës) si dhe Certifikatat ISO kërkuar sipas pikës 2.3.9, nga shqyrtimi dokumenteve të tenderit rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar aspektet në të cila nuk lejohet mbështetja dhe që kanë të bëjnë me kufizimet e përmendura më sipër. KPP gjykon se ligjvënësi përmes *lex specialis*, por edhe rregullat e prokurimit publik, që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit, kanë përcaktuar mundësinë e operatorëve ekonomikë ofertues për tu mbështetur në kapacitetet teknike, profesionale dhe ekonomike të subjekteve të tjera ashtu sikurse kanë lënë në diskrecionin e autoriteti kontraktor që të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës ofertuesi të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, por të përmbushen nga vetë ai me kushtin që ky informacion të publikohet në dokumentet e tenderit. Fakti që ligji dhe rregullat e prokurimit publik i kanë dhënë diskrecionin autoritetit kontraktor që të vendosë kufizime mbi aspekte të caktuara të mbështetjes

në subjektet e tjera nuk do të thotë që ato të bëhen pa një argumentim të saktë dhe të detajuar që justifikon kufizime të tilla. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar në asnjë pikë pse nuk ka lejuar mbështetjen në kapacitet e subjekteve të tjera pikërisht për përvojën e mëparshme të ngjashme dhe për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës dhe certifikatat ISO të kërkuara). Vetë ligjvënësi përmes ligjit për prokurimin publik, por edhe në rregullat e prokurimit publik ka kufizuar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për aspekte kritike ku autoriteti kontraktor në rastin konkret ka dështuar të argumentojë në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim pse elementët më sipër përbëjnë aspekte kritike në raport me aspekte të tjera për të cilat ka lejuar mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera. Përsa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë Seksionin 2: “Objekti i Kontratës”, pika 2.16 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke hequr ndalësën për mbështetjen në kapacitetet teknike të subjekteve të tjerë për të gjithë elementët e përmendur në këtë pikë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Ouen” SHPK, i cili kërkon që të hiqet kufizimi i vënë nga autoriteti kontraktor që nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për të provuar përvojën e mëparshme të ngjashme, përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve objekt i kontratës), referuar arsyetimit të bërë në pikën më sipër III.2.9 të këtij vendimi, pretendimi i këtij operatori ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Ouen” SHPK, për modifikimin e kriterit 2.3.1 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar: *Të modifikohet në përputhje të plotë me parashikimet e pikës 5 të nenit 39 të VKM nr. 285, dat 19.05.2021.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.1., ka parashikuar si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet pa tvsh, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet pa tvsh.

.....

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, i ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat*

e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.3.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”, i ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.3.4 Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, pika 1, i ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

III.3.5. Neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.3.6. Në nenin 39, pikat 4 dhe 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

III.3.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës.

III.3.8. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Ouen” SHPK të paraqitura në ankesë lidhur me kriterin 2.3.1 të të, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend

të ndalet në faktin nëse kërkesa për përvojën e mëparshme, është në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, në fushën e prokurimit publik apo jo. Referuar parashikimeve të nenit 77 të lex specialis, si dhe nenit 39 pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor, që për të verifikuar përmbushjen e aftësive teknike, të mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë, që për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor të kërkojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave-pune të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ku në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose disa punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Nga verifikimet rezulton, se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik në lidhje me vlerën limit të kontratave-pune të ngjashme, nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2022, e ndryshuar.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit 2.3.1., në lidhje me vlerën limit të kontratave të ngjashme, sipas parashikimeve të nenit 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, duke përcaktuar një vlerë brenda diapazonit të parashikuar në këtë dispozitë.

Sa me sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, për modifikimin e kriterit 2.3.1/2 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar:.. *kerkesa per prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit eshte e gabuar dhe duhet te hiqet..*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.1/2., ka parashikuar si më poshtë:

2.3.1/2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve, prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit si dhe preventivin e ndarjes së punëve;

III.4.2. Neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.4.3. Në nenin 88 pika 1,2 dhe 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. *Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

2. *Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*

3. *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

III.4.4. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim

ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.4.5. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues lidhur me kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1/2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit KPP gjykon, se kriteri në fjalë për sa i përket prokurës së posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit, nuk është në përputhje me asnjë nga përcaktimet e *lex specialis*, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, pra autoriteti kontraktor nuk i është përmbajtur parashikimeve ligjore të *lex specialis*, në lidhje me hartimin e këtij kriteri kualifikimi. Ligji për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore përkatëse parashikojnë qartë që anëtarët e një bashkimi operatorësh ekonomikë caktojnë përfaqësuesin e tyre përmes kontratës së bashkëpunimit. Kjo kontratë, e nënshkruar nga të gjithë anëtarët, ka fuqi ligjore autorizuese pa qenë e nevojshme një prokurë e veçantë. Në rastin konkret, KPP vlerëson se kërkesa për prokurë të posaçme nuk është një kërkesë ligjore, përkundrazi ajo është një shtesë e panevojshme dhe si e tillë mund të kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar. Qëllimi i nenit 88 të VKM është të sigurojë që bashkimi të ketë një përfaqësues të qartë dhe të autorizuar, qëllim i cili arrihet përmes kontratës së bashkëpunimit, e cila vërteton përfaqësimin në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, pa pasur nevojë për dokument shtesë, sikurse është prokura e posaçme e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Sa më sipër, Komisioni gjykon se kërkesa për prokurë të posaçme në rast bashkimi operatorësh ekonomikë është e pajustifikuar, e për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij përcaktimi nga kriteri i kualifikimit 2.3.1/2.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Ouen" SHPK për modifikimin e kriterit 2.3.3 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar: uljen e numrit stafit inxhinierik të kërkuar në këtë pikë nga 2 në një të tillë, si dhe të figurojnë në listpagesa vetëm muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Autoriteti kontraktor përmes shkresës nr.8633 prot., datë 08.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2698/2 prot., datë 13.10.2025, ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës, duke modifikuar kriterin si më poshtë:

2.3.3. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar **staf inxhinierik** për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse **si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:**

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshader

1 (një) Inxhinier Gjeolog

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues **dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit** nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V.

Modifikimi i DST është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST.

III.5.2. Nga mënyra se si autoriteti kontraktor ka vendosur të hartojë dokumentet e tenderit për pjesën e pranuar të ankesës, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar dy periudha të ndryshme, sa i përket periudhës kohore në të cilën duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë stafi inxhinierik i kërkuar, duke përcaktuar në një paragraf minimumi tre muaj, ndërsa në paragrafin tjetër për të paktën muajin e fundit. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes për modifikimin e këtij kriteri në mënyrë të tillë që stafi inxhinierik i kërkuar të figurojë në listpagesë vetëm për muajin e fundit, referuar edhe pranimit të bërë nga vetë autoriteti kontraktor lidhur me këtë pikë, të shprehur në paragrafin e parë të këtij kriteri, me qëllim shmangien e konfuzionit që mund të krijojë përcaktimi i bërë nga autoriteti kontraktor, si në hartimin e ofertave nga operatorët ekonomikë ashtu edhe në procesin e vlerësimit nga komisioni i vlerësimit të ofertave, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërpërmendur duke unifikuar periudhën kohore të paraqitjes së stafit inxhinierik në listpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për modifikimin e kriterit 2.3.3 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar heqjen e inxhinierit gjeolog, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.3, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.2 Staf kryesor i kualifikuar për këto punime:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në liçensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
- 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:

- Stafit teknik i sipërcituar duhet të figurojë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V.
Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.6.2. Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëvendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkëvendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-1, N.P-4**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**.

Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkëvendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-7**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**.

Referuar preventivit të Punimeve si dhe në bashkëvendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-4, N.S-6, N.S-18** është e nevojshme prezenca e **Inxhinier Gjeodet/Topograf, Markshajder** pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

III.6.3. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e

prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3, Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.6.4. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.6.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.6.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes të paraqitura në ankesë, sa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor ku si pjesë e stafit të kualifikuar të jetë edhe inxhinieri gjeolog, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin.. Në rastin konkret kemi të bëjmë me punime në rrugë në një zonë të banuar ku roli i inxhinierit gjeolog bëhet edhe më i rëndësishëm, për shkak të rreziqeve dhe kërkesave të shtuara që lidhen me sigurinë e banorëve dhe stabilitetin e zonës. Në këto raste, vlerësimi i kushteve gjeologjike dhe infrastrukturës është më kompleks dhe kërkon më shumë kujdes. Kur kryhen punime rruge në një zonë të banuar, mund të ketë ndikime të ndryshme në stabilitetin e terrenit përreth,

veçanërisht nëse punohet në një zonë ku ka ndodhur shpërbërja e dheut, apo ka probleme me rrëshqitje të tokës. Inxhinieri gjeolog është ai do të vlerësojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e dheut, mundësinë e lëvizjeve të papritura të dheut dhe do të sugjerojë masa parandaluese për të shmangur rreziqe tilla që mund të prekin si sigurinë e rrugës ashtu edhe të banorëve. Po ashtu, prezenca e këtij inxhinieri është e nevojshme sepse kur kryhen punime të kësaj natyre në një zonë të banuar, sikurse është objekti i prokurimit object ankimi, ekziston mundësia që infrastruktura ekzistuese (si shpërndarës uji, kabllot elektrike, linjat e telefonisë, etj.) mund të dëmtohet gjatë punimeve të ndërtimit të rrugës. Inxhinieri gjeolog mund të ndihmojë në vlerësimin e ndikimit të punimeve në këtë infrastrukturë dhe të sigurojë që elementët e ndjeshëm të rrugës dhe infrastruktura të ruhen nga dëmtime. Po ashtu, prezenca e inxhinierit gjeolog është e nevojshme që të analizojë mundësitë e përmbytjes dhe të sugjerojë sisteme të përshtatshme të drenazhimit që do të mbrojnë banesat dhe infrastrukturën e zonës nga dëmet e mundshme, duke pasur patur parasysh faktin se punimet po kryhen në një zonë të banuar dhe uji mund të grumbullohet dhe të shaktojë përmbytje lokale në zonën ku kryhen. Sa më sipër Komisioni gjykon se, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, referuar llojit të kontratatës, volumit dhe përmasave të saj si dhe zërave të preventivit kërkesa e autoriteti kontraktor për 1 (një) inxhinier Gjeolog, i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e autoriteti kontraktor më sipër, përcaktuar, është në propocion me objektin dhe natyrën e kësaj procedure prokurimi, në përputhje me ligjin për prokurimin publik dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë nuk qëndrojnë.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Ouen” SHPK dhe operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për kriterin 2.3.4.A të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar heqjen e këtij kriteri, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1.Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.4.A, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.4.A- Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës, (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Infrastruktura

2 (dy) Inxhinier i specializuar për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punojesit e mesipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. **Inxhinierët, ekspertet e sipërcituar duhet të figurojnë në listëpaqesat e shoqërisë për për te pakten 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.** Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V. Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për personelin inxhinier të sipërcituar dokumentacione të lart përmendur

Shënim: Për pikën 2.3.4 /a,b,c, si më sipër, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

III.7.2. Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

Argumentimi: 2.3.4.a- Ky kriteri shërben Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e punimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK janë kërkuar disa kategori personeli, të domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave/etapave të zbatimit të projektit, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë të veprës.

III.7.3. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3, Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.7.4. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.7.5. Neni 7 i Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, parashikon se:

“1. Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve/grupi i mbikëqyrësve caktohet nga zhvilluesi.

2. Në rastet kur autoritetet publike investojnë dhe realizojnë një zhvillim në një zonë të caktuar, mbikëqyrësi i punimeve/grupi i mbikëqyrësve përzgjidhet nga autoriteti publik në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.”

Ndërsa VKM Nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, në Nenin 9, parashikon se: *“1. Mbikëqyrësi i punimeve miraton materialet e ardhura në kantier përpara se të vendosen në objekt, nëse ato janë në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, standardet e cilësisë së materialeve, si dhe makineritë e pajisjet e siguruara nga zbatuesi i punimeve, të nevojshme në procesin e ndërtimit. Materialet, të cilat nuk marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve, zëvendësohen me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, të cilat duhet të marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve për t’u përdorur në procesin e ndërtimit.*

2. Mbikëqyrësi i punimeve kryen vëzhgimin dhe korrigjimin e detajeve të elementeve të parapërgatitura (parafabrikat), në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, si dhe standardet e cilësisë së materialeve, të cilat do të përdoren në procesin e ndërtimit.

3. Mbikëqyrësi i punimeve duhet të dokumentojë me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, argumentimin e shmangieve të palejuara, referuar standardeve shqiptare ose në mungesë të tyre standardeve evropiane”.

III.7.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.7.6. Lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues mbi disponueshmërinë e punonjësve të specializuar, e më konkretisht 2 (dy) Inxhinier të specializuar për testimin e performancës së produktevetë ndërtimit duke parashtruar argumente se kërkesa për këta inxhinier jo vetëm që është e paligjshme dhe diskriminuese, por edhe e paargumentuar teknikisht dhe si e tillë duhet të hiqet nga kriteret e kualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të

tjera se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë dhe 2 (dy) Inxhinierë të specializuar për testimin e performances së produkteve të ndërtimit. Komisioni gjykon se disponimi nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës i këtyre dy inxhinierëve nuk është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, procesverbalit të hartimit të kriterëve të kualifikimit, ku thjesht ka justifikuar vendosjen e tyre *si personel i nevojshëm i kualifikuar për të zbatuar kontratën*, specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si edhe trajtimit të ankesës së operatorëve ekonomikë ankimues, KPP konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën për disponimin e këtij stafi mbështetës, përcaktuar në pikën 2.3.4.A të dokumentave të tenderit. Në rastin konkret, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij dy inxhinierë të specializuar për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, referuar llojit të kontratës, volumit dhe përmasave të saj si dhe zërave të preventivit kërkesa e autoritetit kontraktor për dy Inxhinierë të specializuar për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit nuk i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, pasi zërat e preventivit nuk justifikojnë kërkesën që të disponohet *ky specialitet*, pra inxhinierë të specializuar për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit, për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e cilësisë së materialeve ndërtimore dhe për sigurimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike, pasi për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, i cili ka detyra dhe përgjegjësi të parashikuara në kuadrin ligjor sektorial, ku ndër to është edhe miratimi i materialeve të ardhura në kantier përpara se të vendosen në objekt, nëse ato janë në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, standardet e cilësisë së materialeve, si dhe makineritë e pajisjet e siguruara nga zbatuesi i punimeve, të nevojshme në procesin e ndërtimit. Materialet, të cilat nuk marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve, zëvendësohen me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, të cilat duhet të marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve për t'u përdorur në procesin e ndërtimit.

Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e dy Inxhinierëve të specializuar për testimin e performances së produkteve të ndërtimit duhet të hiqet, për sa kohë referuar bazës ligjore sektoriale në ndërtim, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e cilësisë së materialeve ndërtimore dhe për sigurimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike realizohet nga mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, pa qenë nevoja e profilizimeve si më sipër. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues lidhur me këtë pikë qëndrojnë.

Lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues mbi disponueshmërinë e punonjësve të specializuar, e më konkretisht të 1 (një) Inxhinier infrastrukture duke pretenduar heqjen e këtij kriteri Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesat në fjalë shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, referuar llojit të kontratës, volumit dhe përmasave të saj si dhe zërave të preventivit kërkesat e autoriteti kontraktor për 1 (një) Inxhinier infrastrukture i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimi Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se objekti i kontratës është ndërtim rruge, që për nga natyra, referuar edhe preventivit të punimeve përfshin një sërë punimesh komplekse infrastrukture si: punime të shtresave rrugore, punime të kanalizimeve, etj të cilat kërkojnë njohuri të specializuara inxhinierike në fushën e projektimit, ndërtimit dhe mbikëqyrjes së infrastrukture, pra prezencën e inxhinierit të infrastrukturës. KPP vlerëson se prezenca e tij në stafin e kërkuar është e domosdoshme për zbatimin korrekt të projektit teknik të rrugës, koordinimin e punimeve dhe sektorëve të ndryshëm (gërmime, ujësjellës, kanalizime, ndriçim, etj.) Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e autoriteti kontraktor më sipër, është në propocion me objektin dhe natyrën e kësaj procedure prokurimi, në përputhje me ligjin për prokurimin publik dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Sa më sipër pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues lidhur me këtë pikë nuk qëndrojnë.

III.8.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Ouen”SHPK dhe operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për kriterin 2.3.4.c të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar modifikimin e këtij kriteri, e më konkretisht heqjen e licencës Grumbullim dhe transportim i ujrave të ndotura, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1.Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.4.c , të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.4/c -Operatori ekonomik te disponojë liçense lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit për grumbullim ruajtje dhe transportim të mbetjeve jo te rrezikshme , Grumbullim dhe transportim i ujrave të ndotura me Kodin III.2.B shoqeruar me aktin e miratimit.

III.8.2.Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

Argumentimi: 2.3.4/c/ Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”. Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar,

parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”. Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

III.8.3. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3, Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.8.4. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.8.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të

detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Lidhur me kërkesën e operatorëve ekonomikë ankimues për heqjen e kategorisë së licencës për “Grumbullim dhe transportim i ujrave të ndotura të lëshuar nga QKL, Kodi III.2.B”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet. Referuar VKM nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme. Licenca III.2.B kërkohej për projekte të cilat përfshijnë aktivitete të tilla si pastrimi, trajtimi dhe shpërndarja e mbetjeve jo të rrezikshme. Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këtë kriter kualifikimi Licenca III.2.B për trajtimin e ujërave të ndotura. Referuar natyrës së punimeve të objektit të kontratës, së bashku me preventivin e punimeve të ngarkuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se nga autoriteti kontraktor është kërkuar kjo kategori license e cila lidhet me objektin e kontratës objekt prokurimi. Referuar zërave të punimeve KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të licencës për Grumbullim dhe transportim i ujrave të ndotura është proporcionale me objektin dhe natyrën e kontratës objekt prokurimi. Sa më sipër Komisioni gjykon se kjo kërkesë nuk është e ekzagjeruar dhe jashtë objektit të kontratës që prokurohet sepse është në përpjestim të drejtë me volumin e saj, objektin e prokurimit dhe zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.

Sa më sipër pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndrojnë.

III.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për kriterin 2.3.5 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar heqjen e kërkesës për punonjes të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.5, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) punonjës për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Staf i menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës përkatëse në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.

2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.9.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.9.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.9.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:
 - a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
 - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
 - c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
- 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi

të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.9.5. Në nenin 39 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.9.6. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me këtë kriter autoriteti kontraktor ka argumentuar:

Argumenti: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej **67 punonjësish**, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda **188 dite pune**, nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

III.9.7. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe

mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimesit i cili pretendon se *“Kërkesa për prezencën në listëpagesë për 3 muajt e fundit është jo proporcionale dhe e panevojshme, pasi operatori ekonomik tashmë disponon stafin e duhur për të përmbushur detyrimet kontraktuale”* Komisioni gjykon se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik lidhur me vërtetimin e administratës tatimore dhe të listpagesave të punonjësve për periudhën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, është një kërkesë e ekzagjeruar në këtë procedurë prokurimi. Komisioni gjykon se operatorët ekonomikë për shkaqe nga më të ndryshmet, janë të detyruar që të bëjnë ndryshime në stafin e tyre çka cdo të thotë që kjo nuk është një e dhënë statike e pandryshueshme në kohë. Ndryshueshmëria e stafit të operatorëve ekonomikë lidhet me praktikën e brendshme të tyre dhe nuk ndikon aspak në tregues të performancës që duhet t'i shërbejë autoritetit kontraktor si garanci në kriteret kualifikuese. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë që punonjësit për kryerjen e punës të figurojnë në listagesat e sigurimeve shoqërore apo vërtetim nga administrata tatimore ku për tre muajt e fundit të specifikohet numri i punonjësve, pasi operatorët ekonomike në varësi të nevojave të tyre kanë të drejtë të shtojnë apo reduktojnë staf në periudha të caktuara kohore. Komisioni gjykon se e rëndësishme është që operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave të kenë në dispozicion stafin e kërkuar nga autoriteti kontraktor i cili do të përbënte garanci se kontrata që do të lidhet si rezultat i procedurës së prokurimit do të realizohet në kohë dhe me sukses.

Kriteri sa më sipër që punonjësit për kryerjen e punës të figurojnë në listagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave apo vërtetim nga administrata tatimore po për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës dhe është tërësisht i panevojshëm. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që në drejtim të plotësimit të kapacitetit teknik profesional operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave me anë të dokumentacionit konkret të lëshuar nga organet kompetente provojnë se disponojnë numrin e kërkuar të punonjësve dhe gjithashtu punonjësit aktualë të jenë të siguruar por kurrësesi të kushtëzojë operatorët ekonomikë që të vërtetojë një numër të tillë punonjësish për periudhën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si punonjësit të figurojnë në listagesa për të gjithë periudhën e specifikuar më sipër. Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në lidhje me periudhën kohore të kërimit të vërtetimit të numrit të punonjësve dhe listagesave të tyre pasi sic është argumentuar më lart e rëndësishme është që në momentin e hapjes së ofertave të vërtetohet numri i punonjësve në përmbushje të kapacitetit profesional.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Qen” SHPK për kriterin 2.3.5 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar heqjen e

kerkeses për punonjes të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, referuar arsyetimit të bërë në pikën III.9.7 të këtij vendimi, ky pretendim qëndron.

III.10.1. Sa i përket kërkesës së operatorit ekonomik “Ouen SHPK për uljen e numrit të punonjësve të kërkuar në këtë pikë (2.3.5) e më konkretisht modifikimin e këtij numri në 50 punonjës për muajin e fundit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor përmes shkresës nr.8633 prot., datë 08.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2698/2 prot., datë 13.10.2025, ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës, duke modifikuar kriterin si më poshtë: *Pika 2.3.5 e DST së procedurës së prokurimit të modifikohet, ku operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) punonjës për periudhën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave ku përfshihen edhe stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik.* Referuar argumentimit të bërë nga autoriteti kontraktor në përlllogaritjen sa i përket numrit të fuqisë puntore, përcjellë pranë KPP me shkresën nr.9077/2 prot., protokolluar me tonën me nr.2698/4 prot., datë 30.10.2025, si dhe vendimit të KSHA, lidhur me trajtimin e këtij pretendimi, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor ka arritur të justifikojë teknikisht dhe ligjërisht kërkesën për një punësim jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) punonjës për realizimin e kontratës, por sa i përket përcaktimit të bërë nga ky i fundit (periudhën 3 muajt e fundit) Komisioni gjykon se referuar arsyetimit të bërë në pikën III.9.7 të këtij vendimi ky përcaktim duhet të hiqet dhe të vendoset vetëm për periudhën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Gjithashtu KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për reflektimin e ndryshimeve në lidhje me kërkesën (periudhën 3 muajt e fundit) duke e modifikuar në “vetëm për periudhën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave”, në të gjithë kriteret ku citohet ne dokumentat e tenderit.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.11.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për kriterin 2.3.6 e 2.3.7 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar uljen e numrit të kërkuar të specialistëve të kërkuar në këtë pikë, heqjen e kërkesës për përfshirjen e tyre në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit si dhe heqjen e kërkesës për certifikatë të sigurimit teknik, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.11.1.Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.6 e 2.3.7, të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si mëposhtë:

2 (dy)	Teknik Ndërtimi
1 (një)	Teknik Gjeodet/Topograf/Markshajder
2 (dy)	Teknik Elektrik
4 (kater)	Hidraulikë
2 (dy)	Elektracistë
5 (pesë)	Karpentierë
3 (tre)	Hekurkthyes
3 (tre)	Betonues

8 (tetë)	Punëtorë asfalti
4 (katër)	Specialistë Ndërtimi
10 (dhjetë)	Punëtorë

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër I punonjësit	Profesioni	Institucioni public/privat lëshues I certifikatës/diplomës	Nr/data e certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.					
2.					
etj.					

* Disponimi i stafit/punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: Për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, dëshmitë/certifikatat ose cdo dokument tjetër që vërteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

- Kontrata e punës e vlefshme,
- Dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose të lartë,
- certifikate të sigurimit teknik të lëshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Secili specialist i sipërcituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi **3** (tre) shofere të mjetëve të rënda/kamioni dhe **(8)** tete) manovratorë (3 automakinist, **3** (tre) eskavatoristë dhe **2** (dy) buldozerist, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për të paktën tre muajt e fundit.

Në rastin kur mjetet/makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Për stafin manovratorë/automakinist të paraqiten: Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndertimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;
- Edhe për stafin e manovratoreve dhe shofereve të paraqitet lista tabelare si me poshte:

Nr.	Emër Mbiemër I punonjësit	Profesioni	Institucioni public/privat lëshues I certifikatës/Lejes Drejtimit	Nr/data e certifikatës/Lejes drejtimit
1.				
2.				
etj.				

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.11.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi uljen e numrit të specialistëve të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.6 e më konkretisht; *kërkesa për 2 (dy) teknikë ndërtimi është e tepruar, pasi roli përmbushet nga 1 (nje) teknik ndërtimi dhe nga inxhinieri i ndërtimit që është pjesë e stafit drejtues teknik; Kërkesa për 1 (nje) teknik topograf është e panevojshme, pasi roli i tij mbulohet nga inxhinieri topograf i stafit drejtues teknik; kërkesa e Autoritetit Kontraktor për të pasur në dispozicion 2 (dy) teknikë elektrikë dhe 2 (dy) elektrikistë është e pajustificuar, pasi preventivi nuk përmban punime elektrike që të kërkojnë praninë e këtij stafi të specializuar, Kërkesa për 5 (pese) karpentierë është e pajustificuar; Kërkesa për 3 (tre) hekurkthyes është e tepruar dhe jo proporcionale, mjafton 1 hekurkthyes për të përmbushur punimet; Specialistët, elektrikistë dhe hidraulikë janë të panevojshëm, pasi preventivi nuk parashikon punime elektrike apo hidraulike; Kërkesa për 4 (kater) specialist*

ndertimi ështëë tepruar, kur sipas preventivit mjafton 1 (nje) specialist pasi referuar profesioneve qe autoriteti ka kerkuar ne thelb edhe karpentieri, betonuesi, punonjesi i asfaltit, elektrikisti etj. jane specialiste dhe rolet mbulohen nga profesionistet e tjere te kerkuar, referuar objektit dhe volumit të kontratës objekt-prokurimi, sasive dhe karakteristikave të punëve të parashikuara në preventiv, si dhe analizës së fuqisë punëtore të bëra nga autoriteti kontraktor, përcjellë pranë KPP me shkresën nr.9077/2 prot., datë 28.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2698/4 prot., datë 30.10.2025, Komisioni gjykon se kjo kërkesë e autoritetit kontraktor nuk është kufizuese, ajo është në proporcion me objektin dhe natyrën e kësaj procedure prokurimi, në përputhje me volumin dhe objektin e kontratës. Në rastin konkret, procedura e prokurimit objekt ankimi është ndërtim i rrugëve në të cilën përfshihen punime të natyrës gërmime dheu me eskavator, transport dheu, shtresë stabilizanti, spostim shtylle elektrike, f.v tuba të brinjëzuar, etj punime të cilat referuar sasive respektive të përcaktuara në preventiv, kërkojnë numrin e specialistëve të kërkuar nga autoriteti kontraktor, me qëllim realizimin në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë.

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues për uljen e numrit të stafit të kërkuar në pikën 2.3.7 të kriterëve të kualifikimit (3 shoferë dhe (8) tete) manovratorë (3 automakinist, 3 (tre) eskavatoristë dhe 2 (dy) buldozerist, nuk është proporcionale me natyrën, vlerën dhe volumet e punimeve të objektit), Komisioni vlerëson se, referuar argumentimit të bërë nga autoriteti kontraktor lidhur me fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës, pjesë e të cilit janë edhe punonjësit e kërkuar në pikën 2.3.7 të kriterëve të kualifikimit, si dhe vendimit të KSHA për uljen e numrit të stafit inxhinierik të kërkuar, ky është një pretendim i cili nuk qëndron pasi numri i fuqisë punëtore të kërkuar nga autoriteti kontraktor, ku përfshihen edhe punonjësit e pikës 2.3.7, është një kërkesë në përputhje me volumin dhe objektin e kontratës.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimuese për heqjen e kriterit për pajisjen e punonjësve me certifikata sigurimi teknik, të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose organizma ekuivalente ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë për specialistët e kërkuar në pikën 2.3.6 të kriterëve të kualifikimit, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor ka përcaktuar drejt dhe me qëllim të sigurisë së përgjithshme të procesit të punës kërkesën për paraqitjen e këtyre certifikatave për të gjithë specialistët e përfshirë. Për më tepër, në analizimin e preventivit të punimeve të procedurës së prokurimit, është evidentuar se ndër veprimet që parashikohen është edhe spostimi i shtyllave elektrike, aktivitet që ka lidhje të drejtpërdrejtë me infrastrukturën elektrike dhe mund të përfshijë rreziqe nga energjia elektrike. Ky aktivitet ka natyrën e një pune të rrezikshme, për të cilën duhen të përcaktohen kërkesa të veçanta për sigurimin e kushteve të punës dhe për mbrojtjen e punonjësve nga rreziqet e mundshme. Ligji nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe të Instalimeve Elektrike", i ndryshuar, përcakton qartë kërkesat për sigurinë e punës në impiantet dhe pajisjet elektrike, përfshirë aktivitete që mund të jenë të rrezikshme, si puna me linjat elektrike të tensionit të lartë, shtyllat elektrike, dhe pajisje të tjera që lidhen me energjinë elektrike. Pajisja e specialistëve me certifikata sigurimi teknik është një masë preventive që siguron përmbushjen e këtyre kërkesave ligjore dhe garanton që specialistët që do të kryejnë punime të tilla të jenë të trajnuar dhe të certifikuar për të menaxhuar rreziqet që mund të shfaqen gjatë punës. Për më tepër autoriteti kontraktor ka lënë mundësi alternative për paraqitjen e këtyre certifikatave nga organizata të tjera të njohura dhe të akredituara që respektojnë standardet ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik lidhur me këtë pikë nuk qëndron.

Sa i përket pretendimit të ankimuesit për heqjen e kërkesës për përfshirjen e tyre në listpagesa për periudhën 3 muajt e fundit për këta punonjës, Komisioni vlerëson se referuar arsyetimit të bërë në pikën III.9.7. të këtij vendimi ky pretendim qëndron.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.12. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Ouen” SHPK për kriterin 2.3.6 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar heqjen e kërkesës për punonjës të përfshirë në listpagesa për periudhën 3 muajt e fundit, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se referuar arsyetimit të bërë në pikën III.9.7 të këtij vendimi ky pretendim i ankimuesit qëndron e për rjedhojë autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij përcaktimi duke e modifikuar vetëm për periudhën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave.

III.13. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për kriterin 2.3.8 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, *se autoriteti kontraktor ka përcaktuar ndër to mjete të cilat nuk korespondojnë me nevojat reale të objektit*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.13.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.8, të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.8 *Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit):*

Nr	Lloji i makinerive	Sasia	Pronësia
1	<i>Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton</i>	<i>3 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
2	<i>Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 11- 19 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
3	<i>Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 - 10 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
4	<i>Kamionçina me kapacitet mbajtës deri ne 3 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
5	<i>Kamion Vinç</i>	<i>1 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
6	<i>Eskavator me krah te gjate mbi 18 m</i>	<i>1 cope</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
7	<i>Automjet teknologjik i specializuar per pastrimin e pusetave me bot uji me kapacitet mbajtes jo me te vogel se 4 ton</i>	<i>1 cope</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
8	<i>Makineri per ndertim mikrotunel D=400 mm me lazer, per kalim tubi</i>	<i>1 cope</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
9	<i>Rrul (shtresash) gome hekur mbi 15 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
10	<i>Rrul asfalt hekur hekur</i>	<i>2 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
11	<i>Rul shtresash me gunga</i>	<i>1 cope</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
12	<i>Fadromë me goma me kovë para mbrapa</i>	<i>2 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>
13	<i>Dumper kantieri</i>	<i>2 copë</i>	<i>Në pronësi ose me qera</i>

14	Eskavator me zinxhir mbi 15 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
15	Eskavator me zinxhir me cekic pneumatic	1 copë	Në pronësi ose me qera
16	Eskavator me goma	2 copë	Në pronësi ose me qera
17	Minieskavator me zinxhir gome	1 copë	Në pronësi ose me qera
18	Grejder me goma	2 copë	Në pronësi ose me qera
19	Asfaltoshtruese	1 copë	Në pronësi ose me qera
20	Autobitumatriçe	1 copë	Në pronësi ose me qera
21	Autobot Uji	2 copë	Në pronësi ose me qera
22	Autobetoniere	2 copë	Në pronësi ose me qera
23	Autopompë betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
24	Makineri (spërkatës) për vijezim rruge me bojë bikomponente	1 copë	Në pronësi ose me qera
25	Betonierë kantieri 0.5m ³	2 copë	Në pronësi ose me qera
26	Betoforma (armaturë, kallëp) dërrase	1500 m ²	Në pronësi ose me qera
27	Pajisje për hekurkthyes (tranxhë / elektrobango)	1 copë	Në pronësi ose me qera
28	Rimorkatior	1 copë	Në pronësi ose me qera
29	Total station	1 copë	Në pronësi ose me qera
30	GPS	1 copë	Në pronësi ose me qera
31	Radio dedektor kabuj nentokesor	1 copë	Në pronësi ose me qera
32	Nivelues/Helikopter betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
33	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
34	Vibrator betoni	3 copë	Në pronësi ose me qera
35	Tokmak për ngjeshje dheu (kompatator)	1 copë	Në pronësi ose me qera
36	Gjenerator $\geq 2.5\text{kë}$	1 copë	Në pronësi ose me qera
37	Pompe uji per pastrim pusetash	1 copë	Në pronësi ose me qera
38	Kulle Ndricimi	1 copë	Në pronësi ose me qera
39	Set semaforesh	1 copë	Në pronësi ose me qera
40	Saldatriçe	1 copë	Në pronësi ose me qera
41	Kompresor ajri	1 copë	Në pronësi ose me qera
42	Impiant (fabrikë) prodhim asfalti me QKL + Karte teknologjike bashkangjitur Vertetimin Teknik per Miratimin e projektit teknologjik lidhur me prodhimin e Asfaltobeton me QKL III.1.B per Rikuperim Mbetjesh jo te Rrezikshme Në rastin kur Operatorët paraqesin kontrate furnizimi, ky kriter do të konsiderohet i plotësuar me paraqitjen e kontratës dhe nuk është e domosdoshme paraqitja me QKL III.1.B	1 copë	Në pronësi/me qera/kontrate furnizimi
43	Impiant (fabrikë) prodhim betoni me QKL Në rastin kur Operatorët paraqesin kontrate furnizimi, ky kriter do të konsiderohet i plotësuar me paraqitjen e kontratës dhe nuk është e domosdoshme paraqitja e lejes me QKL	1 copë	Në pronësi/me qera/kontrate furnizimi

44	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B) Në rastin kur Operatorët paraqesin kontratë furnizimi, ky kriter do të konsiderohet i plotësuar me paraqitjen e kontratës dhe nuk është e domosdoshme paraqitja e lejes mjedisore për të vërtetuar aktivitetin	1 copë	Në pronësi/me qera/kontrate furnizimi
----	--	--------	---------------------------------------

Në rastin kur Operatorët paraqesin kontratë qera/kontrate furnizimi për materialet e mesiperme (Inerte), ky kriter do të konsiderohet i plotësuar me paraqitjen e kontratës dhe nuk është e domosdoshme paraqitja e lejes mjedisore për të vërtetuar aktivitetin

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 67copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Jelek pune 67 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 40 copë

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8. Por shtojca duhet të shoqerohet me te dhena te qarta si me poshte:

Për mjetet në pronësi duhet të plotësohet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), numri I shasisë dhe targa.

Për mjetet, pajisjet dhe materialet ne pronesi që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten ne formularin e vetedeklarimit numri I fatures dhe data ose data e kontrates se shitblerjes, deklarata doganore ose cdo document tjeter qe verteton pronesine.

Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), numri I shasisë dhe targa.dhe numri rep. Kol i kontrates se qerasë si dhe data e fillimit dhe data e mbarimit te kontrates se qerase.

Për mjetet, pajisjet dhe materialet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të deklarohet numri dhe data e fatures tatimore ose doganore, kontrata e shitblerjes ose cdo document tjeter qe verteton pronesine. Kur keto mjete, material ose pajisje jane me qera shenohet edhe numri Rep.Kol I Kontrates se Qearase, afati si dhe data e fillimit dhe mbarimit te saj.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklarara sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese ne shtojcen nr.8 te dst. Plotesimi i shtojces jo sipas kerkesave te dst perben shkak per skualifikimin e ofertuesit.

g) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikatë për transport mallrash.

b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.

c) Për mjetet, pajisjet dhe materialet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij. Në formularin e deklarimit për fazën e parë kjo behet përmes paraqitjes së formularit të vetedeklarimit ku duhet të shënohen qartë numri dhe data e dokumentit që tregon pronesinë, si dhe të dhënat e kontratës së qerash kur mjeti ose pajisja është marrë me qera të cilës i bashkëngjiten edhe të dhënat e dokumentit bazë të pronesisë.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe e materialeve e makinerive të kërkuara sipas pikës 2.3.9 të DST.

e) Për autotumatriçe të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshme për mjetet që kërkohej një dokument i tillë.

f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.

g) Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pikë 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

III.13.2. Në nenin 77 pikë 1 dhe 4 "Kërkesat për kualifikim" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar shprehimisht thuhet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës."

Neni 39, pikë 4 dhe 6, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikon se: "4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:
- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
 - b) *që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
 - c) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
 - ç) *fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
 - d) *mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."*

III.13.3.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumnin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues sa i përket heqjes së disa prej makinerive të kërkuara në pikën 2.3.8 e më konkretisht: Kërkesa për eskavator me krah të gjatë mbi 18 m është e pajustificuar, duke qenë se në preventivin e punimeve nuk parashikohen zëra që kërkojnë përdorimin e kësaj makinerie të specializuar dhe duhet të hiqet; Automjet teknologjik i specializuar për pastrimin e pusetave me bot uji me kapacitet mbajtes jo me të vogël se 4 ton ...Kjo kërkesë është jo proporcionale, sepse nuk ka zëra në preventiv që parashikojnë ndërhyrje me mjete të tilla të specializuara; Në preventivin e punimeve të objektit që prokuohet nuk parashikohen Vendosije të tubacioneve nëntokësore me metoda pa hapje të gropave të mëdha prandaj kërkesa për Makineri për ndërtim mikrotunel D=400 mm me lazer, për kalim tubi është joproportionale dhe e pajustificuar dhe jashtë natyrës së kontratës;; Gjithashtu Rul shtresash me gunga përdoret kryesisht për shtresat bazë dhe mbushje masive, në segmente me volum të madh punimesh rrugore... Prania e këtij mjeti në listën e kriterëve është e panevojshme dhe joproportionale; Bazuar në preventivin e punimeve, kërkesa për Total Station mund të konsiderohet e mbuluar nga GPS, sepse punimet e planifikuara (gërmime, mbushje me cakëll/gurë, shtresa stabilizanti, asfalti apo punimet në trotuar, etj.) nuk kërkojnë matje gjeodezike nga një Total Station. Pra, një GPS është i mjaftueshëm; Referuar preventivit të punimeve për objektin që prokuohet kërkesa për Radio dedektor kabuj nën tokë duket gjithashtu e tepruar ; kërkesa për kullë ndricimi është e panevojshme dhe nuk ka lidhje me natyrën e punimeve; Edhe set semaforësh nuk është e lidhur ngushtë me natyrën e punimeve të preventivit, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, përkatësisht grafikut dhe preventivit të punimeve, Komisioni konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor, në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta për kualifikim për procedurën objekt ankimi, nuk është argumentuar se

përse këto kategori mjeteve janë të domosdoshëm në realizimin me sukses të kontratës. Po ashtu, nga ana e autoritetit kontraktor në shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk është argumentuar se heqja e mjeteve të mësipërme ndikon në cilësinë e realizimit me sukses të punimeve dhe njëkohësisht të kontratës objekt prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt - prokurimi, por në çdo rast këto specifikime teknike duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuar teknikisht, bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e specifikimeve teknike joproporcionale dhe të pajustificuara, shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kërkesën lidhur me këto makineri dhe nëse vlerëson se vendosja e tyre është e domosdoshme, si dhe ndikon në realizimin me sukses të kontratës të justifikojë dhe argumentojë teknikisht vendosjen e tyre.

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues për uljen e disa prej makinerive të kërkuara në pikën 2.3.8 të kriterëve të kualifikimit, e më konkretisht: *Në preventivin e punimeve të kontratës që prokuohet volumet e gërmimeve dhe mbushjeve janë të vogla dhe mund të përballohen nga 1 fadromë, duke qenë se objektet e punës janë të kufizuara dhe nuk ka nevojë për dy mjete identike prandaj kërkesa për 2 fadroma është e tepruar dhe joproporcionale; Duke qenë se Volumet e punimeve janë të kufizuara dhe një eskavator me goma është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e kontratës edhe Kërkesa për dy eskavatorë me goma identikë është jo proporcionale me natyrën e kontratës; Kërkesa për dy dumpera kantieri është e tepruar dhe krijon një barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë; Kërkesa për 2 grejderë identikë është e panevojshme dhe tejkalon nevojat reale të kontratës, Kërkesa për 2 autobotë uji identikë është e tepruar dhe krijon barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë*, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, autoritetit kontraktor në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta për kualifikim për procedurën objekt ankimi, nuk ka justifikuar dhe as argumentuar teknikisht dhe analitikisht, nevojën për numrin e pajisjeve të tilla. Në këto kushte, KPP vlerëson se autoriteti kontraktor duhet ripërllogarisë numrin e mjeteve të sipërcituara, duke i modifikuar ato në përputhje dhe proporcion me volumet e parashikuara në kontratën objekt prokurimi. Sa më sipër, Komisioni gjykon se, referuar testit të proporcionalitetit, kërkesa në fjalë e autoritetit kontraktor mbi disponimin e mjeteve nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nuk është në proporcion dhe në përputhje me përmasat dhe volumin e kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kërkesën për numrin e mjeteve dhe të përcaktojë një numër të nevojshëm për mjetet për realizimin me sukses të saj.

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se: *kërkesa për pajisjen me targa të mjeteve teknologjike si grejderi është juridikisht e gabuar. Sipas Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, detyrimi për regjistrim dhe pajisje me targa aplikohet për mjetet që qarkullojnë në rrugë publike. Grejderi është mjet teknologjik që përdoret vetëm brenda kantierit dhe transportohen mbi rimorkiatorë nga një kantier në tjetrin. Ato nuk janë mjete të destinuara për qarkullim të pavarur në rrugë publike dhe për rrjedhojë nuk kanë detyrim ligjor për t'u pajisur me targa. Për pasojë, vendosja e një kushti të tillë nuk ka bazë ligjore, Neni 58, i Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se “Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë...”. Fakti që këto mjete janë me goma jo domosdoshmërisht përcakton*

dhe detyrimin që të pajisen me targa. Ndërkohë në nenin 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 4 përcaktohet se: *për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit, ndërsa në rastin kur lëvizin vetëm në kantier atëherë nuk kanë detyrim që të pajisen me targa.* Sa më sipër, Komisioni vlerëson se përcaktimi i autoritetit kontraktor për pajisjen me targa të mjeteve teknologjike, e më konkretisht grejderit, mjet, i cili përdoret brenda kantierit dhe mund të transportohet me mjete të tjera pa qenë e nevojshme të qarkullojë në rrugë publike, është një përcaktim i cili bie ndesh me bazën ligjore të sipërpermendur. Për rrjedhojë, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri duke hequr kërkesën për pajisjen me targa për këtë kategori mjeti teknologjik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë pjesërisht.

III.14. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Qun” SHPK për modifikimin e kriterit 2.3.9 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, me arsyetimin se : *Konstatohet se në këtë kriter 3 prej 5 certifikatave janë totalisht të paligjshme të paargumentuara ligjërisht dhe teknikisht, të cilat janë: ISO 45001:2018 / 2023(Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë) , ISO 1452-1:2009 (Sistemet e Tubacioneve Plastike per Furnizimin me Uje dhe Kanalizimet), ISO 39001:2012 (Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor) Keto certifikata nuk gjenden në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe per këtë arsye kërkojmë që të hiqen, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.14.1.Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.9, të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

*** ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë)**

*** ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)**

*** ISO 45001:2018 / 2023(Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë)**

*** ISO 1452-1:2009(Sistemet e Tubacioneve Plastike per Furnizimin me Uje dhe Kanalizimet)**

*** ISO 39001:2012 (Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor)**

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar.

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë ISO duhet plotësuar nga operatorët ekonomik, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.

Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.14.2. Në pikën 2 të nenit 41, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*

Ndërsa në nenin 44, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. 3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

III.14.3. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Në rastin konkret lidhur me kërkesat e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik të paraqesë *certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve: ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë), ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor), ISO 45001:2018 / 2023(Sistem i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në punë) ISO 1452-1:2009(Sistemet e Tubacioneve Plastike për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet) ISO 39001:2012 (Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor)*, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesat në fjalë shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP konstaton se objekti i procedurës së prokurimit është ndertim rruge.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për heqjen e certifikatës *ISO 39001:2012 (Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor..)* KPP nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të ngarkuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor, konstaton se në dokumentin Relacion teknik, ka bërë një përshkrim të sinjalistikës rrugore, mbi mënyrën se si do të realizohet vendosja e sinjalistikës horizontale dhe asaj vertikale. Certifikata ISO 39001:2012, është një mënyrë për t'u siguruar që një organizatë ka marrë masat e nevojshme për të garantuar sigurinë e udhëtarëve, shoferëve, dhe punonjësve të tjerë të përfshirë në aktivitetet e saj që lidhen me trafikun rrugor. Pra, kur një rrugë është në ndërtim, mund të ketë masa për të menaxhuar rrugën e kalimit dhe drejtimin e trafikut, duke përdorur sinjalizim të përkohshëm, si tabela rrugore, sinjalizues të ndriçuar etj. Në rastin konkret, zëra të tillë nuk janë cituar në preventivin e punimeve të ndërtimit të rrugës. Kjo certifikatë ka të bëjë me tepër me menaxhimin logjistik të personelit dhe të mjeteve, për Menaxhimin e Sigurisë në Trafikun Rrugor, kur rruga është në funksion ose në përdorim, pas kolaudimit të veprës. Sa më sipër arsyetuar KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, referuar llojit të kontratës, volumit dhe përmasave të saj si dhe zërave të preventivit kërkesat e autoriteti kontraktor për certifikatën *ISO 39001:2012 (Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor)* nuk i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Kriteri i sipërpërmendur i vendosur nga autoriteti kontraktor nuk është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, ndaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij kriteri të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për heqjen e certifikatës *ISO 1452-1:2009 (Sistemet e Tubacioneve Plastike për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet)*, KPP nga shqyrtimi i procesvrbalit për argumentimin e kriterëve të kualifikimit të ngarkuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor konstaton se nuk ka dhënë asnjë argumentim lidhur me vendosjen e këtij kriteri kualifikimi. Certifikata ISO 1452-1:2009 është një standart që lidhet me Sistemet e tubacioneve plastike për drenazhimin/kullimin pa presion nën tokë dhe sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza pa presion, e cila është një certifikatë që lidhet me cilësinë e produktit, pra duhet ta ketë prodhuesi. Në rastin konkret objekti i prokurimit lidhet me ndertim rruge dhe ofertuesi nuk ka detyrim për të pasur një certifikatë të tillë. Sa më sipër KPP gjykon, se ky kriter nuk është i përshtatshëm për arritjen e synimit të kërkuar dhe shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin duke mos përmbushur në këtë mënyrë edhe testin e proporcionalitetit në lidhje me hartimin e tij. Në këtë kuadër, KPP e gjykon jo të drejtë këtë

kërkesë të autoritetit kontraktor, ndaj ky i fundit duhet të marrë masa për heqjen e tij nga kriteret e kualifikimit.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për heqjen e certifikatës ISO 45001:2018 / 2023 (Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë), KPP nga shqyrtimi i procesvrbalit për argumentimin e kriterëve të kualifikimit të ngarkuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor është argumentuar vendosja e këtij kriteri kualifikimi. Certifikata ISO 45001:2018 është një standard ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, e nevojshme për çdo organizatë pavarësisht nga madhësia. Kërkesa që çdo ofertues të jetë i pajisur me një certifikatë të tillë është një garanci që veprimtaria e tij realizohet bazuar mbi parimin e sigurisë në punë, cka tregon që operatori ekonomik ka marrë masa për të siguruar një mjedis pune të sigurt, duke shmangur aksidentet që mund të rezultojnë nga mjedisi i punës. Në këtë kuadër, KPP e gjykon të drejtë këtë kërkesë të autoritetit kontraktor.

Sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimjes qëndrojnë pjesërisht.

III.15. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, për modifikimin e kriterit 2.3.9 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt – ankimi, i cili kërkon që të hiqet certifikata ISO 1452-1:2009 (Sistemet e Tubacioneve Plastike për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet), referuar arsytimit të bërë në pikën më sipër III.14.3 të këtij vendimi, pretendimi i këtij operatori ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.16. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Quen” SHPK për kriterin 2.3.11 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt – ankimi, duke kërkuar heqjen e këtij kriteri kualifikimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.16.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.2.1, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.11, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.11. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Grafikon e punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të Vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar.

Nërsa në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit” në Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, A Deklaratë parashikohet:

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

“Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

III.16.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për heqjen e kërkesës së kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor për paraqitjen e grafikut të punimeve, Komisioni konstaton se në pikën 2.3.11 autoriteti ka përcaktuar paraqitjen e grafikut të punimeve në përputhje me zërat e punës dhe me afatin kohor në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, në pikën 2.1.a të kriterëve të kualifikimit është përcaktuar paraqitja nga operatorët ekonomikë e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8, ku në pjesën III, Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, operatori ekonomik deklaron ndër të tjera se merr përsipër realizimin e objektit në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Përmes kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.11, autoriteti kontraktor kërkon të sigurojë që operatorët ekonomikë ofertues do të realizojnë punimet në përputhje me zërat e punës dhe brenda afatit të përcaktuar në dokumentat e tenderit, qëllim të cilin e realizon edhe përmes formularit të vetdeklarimit me deklarinë që operatori ekonomik ofertues bën në rubrikën e sipërpërmendur. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e formularit të vetdeklarimit është një kërkesë e mjaftueshme për të siguruar për realizimin sipas preventivit dhe në kohë të objektit të prokurimit. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se kriteri për paraqitjen e grafikut të punimeve përbën një kriter i panevojshëm, e për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e tij nga kriteret e kualifikimit.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë qëndrojnë.

III.17. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Ouen” SHPK dhe operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për kriterin 2.3.13 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt – ankimi, duke kërkuar heqjen e këtij kriteri kualifikimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.17.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.13, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.13. Operatori ekonomik në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates të publikuar në DST, për materialet si më poshtë:

a) Inerte

- b) Bordura
- c) Hekur
- d) Tuba Korrogato
- e) Asfalto-beton

Duhet te paraqese:

Autorizim te Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi/Marrëveshja e bashkëpunimit duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument të paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

1. *Operatori Ekonomik per materialet e mesiperme (Inerte dhe Asfalto-beton) duhet te paraqese dhe lejen mjedisore te vlefshme per zhvillimin e ketyre aktiviteteve (te tijen nese i ka ne pronesi ose te prodhuesit nese i ka me akt marveshje).*

III.17.2.Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.17.3. Në pikën 2 të nenit 41të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”*

III.17.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit

kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Në rastin konkret lidhur me kërkesat e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik të paraqesë autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar për materialet Inerte, Bordura, Hekur, Tuba Korrogato dhe Asfalto-beton Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se objekti i kontratës lidhet me realizimin e punëve (shtrim rruge), të cilat përfshijnë përdorimin e mallrave për realizimin e punës. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të kualifikimit autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri si më poshtë: [...] *Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit , Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjykojme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane[...].* Komisioni vlerëson se kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit shërben për të vlerësuar cilësinë e materialeve dhe përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të projektit. Në shtojcën e specifikimeve teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet e mallrave që kërkohen për realizimin e projektit.

Lidhur me pretendimin e ankimesve për heqjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar për materialet Inerte, Bordura dhe Asfalto-beton Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.8 lidhur me mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës ka kërkuar ndër të tjera Impiant (fabrikë) prodhim asfalti me QKL, Impiant (fabrikë) prodhim betoni me QKL dhe Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B), duke specifikuar lidhur me pronësinë si më poshtë “*Në pronësi/me qera/kontrate furnizimi*”. Një përcaktim i tillë nga autoriteti kontraktor nënkupton që për materialet Inerte, Bordura dhe Asfalto-beton, autoriteti kontraktor i ka lënë mundësinë operatorëve ekonomikë që këto materiale ti sigurojnë nëpërmjet impianteve (fabrikave), nyje inerte, të cilat mund ti kenë në pronësi, me qera ose me kontratë furnizimi. Në rastet kur këto materiale sigurohen nëpërmjet kontratës së furnizimit, në këtë kontratë jepen të dhëna për prodhuesin dhe materialet, cilësinë e tyre. Pra, nëse operatori ekonomik ka një kontratë furnizimi për këto materiale, autorizimi i prodhuesit nuk është më i nevojshëm. Në kontratën e furnizimit ka informacion lidhur me origjinën dhe materialet. Në këtë kuptim autorizimi i prodhuesit është i panevojshëm për rastet kur materialet e sipërpërmendura sigurohen nëpërmjet kontratës së furnizimit. Sa më sipër KPP vlerëson se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë këtë kriter kualifikimi duke hequr paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar për materialet Inerte, Bordura dhe Asfalto-beton në rastin kur këto të fundit sigurohen nëpërmjet kontratës së furnizimit.

Lidhur me pretendimet e ankimesve për heqjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar prej prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar për materialet Hekur dhe Tuba Korrogato, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se ky është një kriter në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, pasi referuar kriterëve të kualifikimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar ndonjë dokument tjetër (katalog/skedë teknike) për të vërtetuar përmbushjen e specifikimeve për këto materiale e për rrjedhojë autorizimi i prodhuesi ose distributorit të autorizuar është dokumenti

që i jep mundësinë autoritetit kontraktor për të bërë këtë verifikim. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa si më sipër të autoriteti kontraktor është në proporcion me objektin e kësaj procedure prokurimi dhe si rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues për heqjen e kriterit 2.3.13, Komisioni konstaton se në këtë kriter autoriteti kontraktor ka bërë një përcaktim i cili vjen në kundërshtim me kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.8 e më konkretisht: përcaktimi i kriterit 2.3.13.: **Operatori Ekonomik për materialet e mesiperme (Inerte dhe Asfalto-beton) duhet të paraqesë dhe lejen mjedisore të vlefshme për zhvillimin e ketyre aktiviteteve (te tijen nese i ka në pronesi ose të prodhuesit nese i ka me akt marveshje), ndërsa në pikën 2.3.8 për këto materiale ka përcaktuar: Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore Kodi III.1.B) Në rastin kur Operatorët paraqesin kontrate furnizimi, ky kriter do të konsiderohet i plotësuar me paraqitjen e kontratës dhe nuk është e domosdoshme paraqitja e lejes mjedisore për të vërtetuar aktivitetin dhe Impiant (fabrikë) prodhim asfalti me QKL III.1.B. Në rastin kur Operatorët paraqesin kontratë furnizimi, ky kriter do të konsiderohet i plotësuar me paraqitjen e kontratës dhe nuk është e domosdoshme paraqitja me QKL III.1.B.**

Me qëllim shmangien e konfuzionit që mund të krijohet si në momentin e ofertimit nga operatorët ekonomikë, por edhe në vlerësimin e ofertave nga komisioni i vlerësimit të ofertave, KPP gjykon se autoriteti duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit 2.3.13 lidhur me këtë përcaktim të bërë duke e unifikuar atë me përcaktimin e bërë në pikën 2.3.8 të kriterëve të kualifikimit.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ouen” SHPK dhe operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62685-09-25-2025, me objekt: “Ndërtim Blloku Paskuqan 2”, me fond limit 107,003,399.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 13.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Ouen” SHPK dhe operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ouen” SHPK dhe operatori ekonomik “Almo Konstruktion” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

